



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot

Datë .10.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shirita dekorues me drita”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

(Drita për pemën e krishtlindjeve) **31522000-1**

(Mjete decorative) **44812400-9**

(Dekorime) **45451000-3**

VLERA E FONDIT LIMIT: 5,900,000 (pesë milion e nëntëqind mijë) lekë PA TVSH.

Autoriteti kontraktor ka llogaritur fondin limit duke marre 3 (tre) oferta nga operatorët ekonomike që operojnë në treg dhe duke përlogaritur vlerën mesatare të tyre në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 76, paragrafi i parë pika b) ,të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare: **2020, 2021, 2022**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 paragrafi 2 pika b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogel se vlera e fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në: *nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nëzbatimtëLigjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, I ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, I ndryshuar, VKM-së Nr.922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe

të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1. Operatorët ekonomikë duhet të dorezojnë :

- a) Operatori duhet të paraqesë jo më vonë se data dhe ora e hapjes së tenderit **mostrat** e materialeve të mëposhtme të cilat duhet të jenë sipas specifikimeve teknike:

NR	Pershkrimi	Njesia	Sasia
1	Shirita dekorativ LED me mundesi bashkimi. Standarti IP44 (outdoor)	cope	1
2	Shirita dekorativ LED me FLASH, me mundesi bashkimi. Standarti IP44 (outdoor)	cope	1
3	Fotosuline dekorative ndricimi (Warm White 4000K)	meter	1
4	Mufta Hermetike per fotosuline	cope	1
5	Shirita bredhi dekorative artificiale	cope	1

Mostrat duhet të dorezohen jo më vonë se data dhe ora e hapjes së tenderit. Mos dorezimi i mostrave brenda afatit do të sjellë skualifikimin e operatorit pjesëmarrës.

Argumentimi:

Kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e *mostrave të mallit* është përcaktuar proporcionalisht dhe në përputhje me objektin e kontratës, bazuar në nenin 77, të LPP, si dhe nenin 40, par.6, pika a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe është vendosur

me qellim qe Autoriteti Kontraktor te vleresoje perputhshmerine e mallrave me standartet teknike si dhe per te garantuar cilesine dhe origjinalitetin e mallrave.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Termet e references, sasite, specifikimet teknike jane hartuar nga personat pergjegjes per hartimin e specifikimeve teknike caktuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Nr. 1405 Prot., date 26.10.2023.

Ato jane si me poshte:

Specifikimi i Materialeve:

NR	Pershkrimi	Njesia	Sasia
1	Shirita dekorativ LED me mundesi bashkimi. Standarti IP44 (outdoor)	cope	250
2	Shirita dekorativ LED me FLASH, me mundesi bashkimi. Standarti IP44 (outdoor)	cope	130
3	Fotosuline dekorative ndricimi (Warm White 4000K)	meter	2000
4	Mufta Hermetike per fotosuline	cope	250
5	Shirita bredhi dekorative artificiale	cope	1500

1-Shirita dekorativ LED me mundesi bashkimi

- Burimit dritës: LED
- Izolimi: IP 44 (outdoor)
- `Jetëgjatësia: 1 vit
- Color Temperature: 4000K(e bardhe e ngrohte)
- Ngjyra e kabllit e gjelber.
- Transformatori: 220 – 240 VAC/31V DC (12W) 5.6W
- Distanca midis llampave 5 cm.
- Nr i llampave me kapuc mbrojtes 1500 cope/njesi
- Gjatesia e 1 njesie 78 meter se bashku me transformator,
- Gjatesia e kabllit me llampa 75 meter.
- Mundesia e bashkimit me mufta hermetike
- Të dhënat e një llampe 3V/20 mA/0.06W/3mm

2- Shirita dekorativ LED me FLASH, me mundesi bashkimi.

- Burimit dritës: LED
- Izolimi: IP 44 (outdoor)
- `Jetëgjatësia: 1 vit
- Color Temperature: 4000K(e bardhe e ngrohte)
- Ngjyra e kabllit e gjelber.

- Transformatori: 220 – 240 VAC/31V DC (12W) 5.6W
- Distanca midis llampave 10 cm.
- Nr i llampave me kapuc mbrojtës 700 cope/njesi
- Gjatesia e 1 njesie 73 meter se bashku me transformator,
- Gjatesia e kabllit me llampa 70 meter.
- Mundesia e bashkimit me mufta hermetike
- Të dhënat e një llampe 3V/20 mA/0.06W/3mm

3-Fotosuline dekorative ndricimi

- Burimit dritës: LED
- Izolimi: IP 67
- Mbrojtja UV
- Color Temperature: 4000K(e bardhe e ngrohte)
- Transformatori: 230V AC 4.3W/m (red: 3.8W/m)
- Distanca midis llampave 3 cm.
- Trashesia e tubit 13 mm
- Tubi te jetë I pajisur me tre fije per lidhjen e llambave dhe të ketë mundesi per prerje ne cdo 1 m.
- Gjatesia max e paketimit 50 meter.
- Mundesia e bashkimit me mufta hermetike
- Të dhënat e një llampe 3V (red: 2V)/20 mA/0.06W (red:0.04W) /3mm

➤ Shënim:

- Paketimi brenda kutise duhet të përmbaje të gjithë pajisjet si:spina,muftë bashkuese,izolues të bashkimit pvc dhe tapa fundore pvc,të domosdoshme për funksionimin e ndricuesit.

4- Mufta Hermetike per fotosuline

- Mufta hermetike per fotosuline me kabell 1 meter dhe spine fundore

5- Shirita bredhi decorative artificiale

- Shirit bredhi dekorativ me permasa 270x30 cm
- Ngjyra jeshile
- Pjese perberese e shiritit te jene edhe dekoracione te tjera :si floke debore, boriga pishe
- Artificiale etj

Specifikimet teknike janë hartuar pas verifikimeve të kryera në lidhje me nevojat që ka qyteti për shirita dekorative për festat e fundvitit.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi :

Kjo kontratë ka për qëllim realizimin e furnizimit me shirita dekoruese të nevojshme për festat e fundvitit.

Kontraktuesi duhet të furnizojë me mallra në përputhje me standartet e kerkuara dhe specifikimet teknike me shpenzimet e tij deri në dorezimin në vendin e përcaktuar që është magazina e ndermarrjes së Sherbimeve publike, Bashkia Korçë.

Afati

10 (dite) dite nga data e lidhjes së kontratës.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Materialet janë kerkuar sipas sasive dhe nevojave efektive për të përmbushur nevojat e ndermarrjes në mënyrë të plote për realizimin e shërbimeve në interes të komunitetit. Materialet janë specifikuar në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për të qenë sa më rezistente dhe të dukshme në rrugë, gjithashtu që do të përmbushin të gjitha standartet.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

➤ **Personi përgjegjës për specifikimet dhe llogaritjen e fondit limit**

Përgjegjëse në sektorin e eventeve